



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.108, Datë, 02.07.2020

“MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 10.11.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A., NË AKTIVITETIN E
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR” TË NDRYSHUAR”,**

DHE

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A., NË AKTIVITETIN E
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr.78/1prot., datë 23.06.2020,” *Mbi një ndryshim në vendimet e bordit të ERE-s nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017*”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 220, datë 20.12.2019, vendosi:
 1. *Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:
- “Të licencojë Shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brënda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”*
 2. *Të miratojë ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:
- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brënda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”*

- Në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë “Albgaz” sh.a., nr. 121 prot., datë 16.06.2020, protokolluar në ERE me nr. 85 prot., datë 18.06.2020, “Kërkesë për shtyrje afati të vendimit mbi licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a.”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.12.2020.

- Kjo kërkesë vjen në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 04.03.2020 për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

- Kërkesa e Shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të nevojshëm është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 220, datë 20.12.2019 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, vlerësojmë se Shoqëria ndodhet në kushtet e pamundësisë për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:
“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brënda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar .

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:
“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brënda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brënda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI